



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/69

Datë: 20.02.2020

Procesverbal

i mbledhjes së I (e parë) të jashtëzakonshme për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -XI- 2019 të KPF-së.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/42 datë:20.01.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për përkrahjen financiare për tri vite të strehimores "Shtëpisë së Sigurt" në Gjakovë.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/44 datë:20.01.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës së parashtruar nga përfaqësuesit e lagjes Kastrati nga fshati Damanek, për shpalljen e pronës publike të parcelës 299-1, për varreza të kësaj lagje në fshatin Damanek KK-Malishevë.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/45 datë:16.01.2020, të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.09/02-MB datë: 09.01.2019, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pikës së transferit, për grumbullimin, transportimin, depozitimin e mbeturinave (jo të ngurta) të cilat grumbullohen nga K.R.M Ekoregjioni Sh.a në Prizren, njësia në Malishevë.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës i Komiteteve dhe Komisioneve për vitin 2020.
 - Komiteti për Komunitete.
 - Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
 - Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Persona me Aftësi të Kufizuara
 - Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës.
 - Komiteti për Diasporë.
 - Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Turizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe monitorim të projekteve publike.
 - Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
 - Komisionit Komunal të Aksionarëve.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2019
7. Shqyrtimi i Raportit të Kompanisë "Hidroregjioni Jugor" njësia në Malishevë për vitin 2019.
8. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2019.
9. Raporti i punës i Drejtorisë për Shërbime Publike për vitin 2019.
10. Shqyrtimi i Raportit të punës i Drejtorisë për Shërbime Publike për të hyrat dhe shpenzimet për pishinën publike në fshatin Banjë.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2020.
12. Formimi i Komisionit për Hartimin e Rregullores për Kriteret e Ndarjes së Çmimeve, Dekorativave dhe Mirënjohjeve.
13. Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve (leximi i parë).
14. Shqyrtimi i kërkesave.
15. Të ndryshme.

Mbledhja e paraparë për tu mbajtur me datë:24.01.2020 është mbajtur me datë: 27.01.2020 duke filluar në ora 13, morën pjesë 4 anëtarë të KPF, zyra për informim, OSBE si dhe anëtari i Kuvendit Ilaz Krasniqi pjesëmarrës në mbledhje.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve e kam thirr këtë mbledhje për datë, 24 janar por me qenë se e kishim një termin në Ambasadën Italiane dhe kemi pas me aplikua për viza, sepse siç e dini kemi një vizitë në Itali bashkë me kryetarin e Komunës dhe unë ju kam informuar që mbledhjen do ta shtyjme për sot. Albanin e kam njoftuar por ai kishte qenë në Shqipëri dhe mbasi ka ardhur ne është dashtë mbledhjen ta shtyjme. Rendin e ditës e keni për disa nga pikat nuk kemi material, a keni diçka për rendin e ditës, nëse jo kush jeni për miratim të rendit të ditës? Unanimisht të gjithë ishin për.

Raimonda Krasniqi: Lidhur me mbledhjet e KPF-së unë po kërkoj por edhe na bashkëpunim me ju që mbledhjet e KPF-së të mbahen ose ditën e Enjte ose të Premte dhe atë pasdite pas që tre dite tjera jam e zënë me punë në Arsim dhe nuk mundem të marr pjesë në mbledhje.

Hashim Vrenezi: Edhe unë pajtoj që pas orës 13:00 t'i mbajmë mbledhjes vetëm që jo ditën e Hënë.

Ilaz Krasniqi: Ka qenë kërkesë e Alban Krasniqit që të paktën rendin e ditës të përcjellin me E-mail.

Rrahim Morina: Ne nganjëherë po kemi telashe me material, sepse po kemi vonesë nga Ekzekutivi.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -XI- 2019 të KPF-së.

Kush jeni për miratim? Unanimisht ishin për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/42 datë:20.01.2020 të parashtruar nga Kryetari i

Komunës, për përkrahjen financiare për tri vite të strehimores "Shtëpisë së Sigurt" në Gjakovë.

Muharrem Morina: Kjo kërkesë ka ardhur edhe pse nga bashkëpunimi me Osbe edhe pse kemi pas menduar me ba marrëveshje me atë shtëpinë e sigurte në Gjakovë. Tani kërkesën e kemi sjellë në KPF, dhe nëse miratohet nga Kuvendi duhet me ba thirrje publike që ata me aplikuar. Shuma është paraparë 250 euro në muaj, në projekt buxhet kjo s'është parapara po që tani Kuvendi me vendim e financon.

Rrahim Morina: Unë personalisht e kam pa të arsyeshme këtë kërkesë.

Hashim Vrenezi: Edhe ne e përkrahim.

Rrahim Morina: Kush jeni që këtë kërkesë ta rekomandojmë për kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/44 datë:20.01.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës së parashtruar nga përfaqësuesit e lagjes Kastrati nga fshati Damanek, për shpalljen e pronës publike të parcelës 299-I, për varreza të kësaj lagje në fshatin Damanek KK-Malishevë.

Muharrem Morina: Këta parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar prej kryetarit dhe Kpf që atë pjesë ose lokacion më caktu si lokacion për varreza, por aty në ju kemi thënë se të gjitha çështjet duhet t'i zgjidhni me lagjen Shala që mos të ketë problem.

Ilaz Krasniqi: Ne edhe kur kemi pas caktuar lokacionin për Memorialin e UÇK-së, ne ju kemi pas thënë se meju larguar atyre pronave private afër në mënyrë që mos mi penguar.

Rrahim Morina: Ata është dashtë të sjellin edhe kopjen e Planit ku po kërkojnë.

Bashkim Krasniqi-Drejtor i Gjeodezisë dhe Kadastrit: Ne kemi dal në teren e kemi bërë incizimin aty kishte gur të varrezave, por aty janë edhe disa prona private, por rrugë me kadastër aty ska. Ata duhet me ba një marrëveshje aty edhe me kalua mbi varreza nuk bën por edhe mi pengu të tjerët.

Hashim Vrenezi: Pjesën që e kanë dhe atë që kërkojnë me caktu vend për varreza duhet me shenjëzuar në plan dhe me ju mundësuar të tjerëve me kaluar dhe mos me caktu vend me shumë se sa ju duhet.

Rrahim Morina: Në kërkojmë nga Drejtoria për Gjeodezi të dalin në teren dhe me kryesinë dhe pronarët të konstatojnë një zgjidhje e pastaj të kthehet edhe një herë kërkesa.

Unanimisht pra këtë kërkesë ja përcjellim Drejtorisë për Gjeodezi.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/45 datë:16.01.2020, të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.09/02-MB datë: 09.01.2019, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pikës së transferit, për grumbullimin, transportimin, depozitimin e mbeturinave (jo të ngurta) të cilat grumbullohen nga K.R.M Ekoregjioni Sh.a në Prizren, njësia në Malishevë.

Muharrem Morina: Kjo kërkesë ka ardhur pasi që a ngrit si çështje edhe në Kuvend, sepse kjo nuk është paraparë as në Pzhk. Aty mbeturinat grumbullohen prej krejt fshatrave dhe pastaj prej aty dërgohen në Landovicë.

Grumbullimi i mbeturinave është çështje e Komunës por edhe Inspektorati ka kërkuar të largohen prej aty, caktimi i një pike transferi është kompetencë e Kuvendit tani në kërkesë i keni disa lokacione, se edhe mbeturinat në hava nuk lihen dikund duhet të caktohet një vend.

Rrahim Morina: Unë mendoj se për këtë pikë na duhet sqarime shtesë.

Hashim Vrenezi: Duhet të ketë plan se aty duhen investime, duhet të caktohet hapësira e nevojshme, të dihet kostoja sa kushton, debat publik duhet të ketë, pastaj duhet të caktohet një vend ku nuk i dëmton qytetarët pra jashtë zonave të banuara.

Rrahim Morina: Duhet të verifikohen tri propozimet se cila është më larg banimit, sa hapësirë kërkohet pra të specifikohet projekti, të ketë debat publik, të dihet kostoja. Këtë kërkesë ja përcjellim zyrës së Kryetarit të Komunës, a jeni për që kjo kërkesë të vjen me material shtesë edhe një herë? Unanimisht të gjithë ishin për.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës i Komiteteve dhe Komisioneve për vitin 2020.

Rrahim Morina: Tani këtu i kemi vetëm disa nga Planet, por jo të gjitha, disa komitete kanë thënë se jemi në përfundim dhe i sjellim në kuvend, a jeni ta rekomandojmë këtë pikë me këto plane që i kemi? Unanimisht ishin për.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2019

Rrahim Morina: Këtë raport jemi duke e punuar për me sjellë në mbledhje të Kuvendit, a jeni që ta rekomandojmë? Unanimisht të gjithë ishin për.

Rrahim Morina: Disa nga Raportet e Drejtorisë për Shërbime Publikë nuk i ka sjellë, pra që janë në rend dite, raporti i Kompanisë Hidoregjioni po ashtu edhe Planin e Zyrës së Prokurimit Publik nuk e kemi. Nëse nuk ka material unë kishë mendu mos t'i rekomandojmë për Kuvend.

12. Formimi i Komisionit për Hartimin e Rregullores për Kriteret e Ndarjes së Çmimeve, Dekorativave dhe Mirënjohjeve.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht të gjithë ishin për.

13. Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve (leximi i parë).

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht të gjithë ishin për.

14. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/04 datë: 09.01.2020 e parashtruar nga Destan Kryeziu nga fshati Pagarushë për ndihmë për bashkëshorten e tij të sëmurë.

Rrahim Morina: Ky që ka parashtruar këtë kërkesë unë e kam pas në zyre ma ka tregu rastin, vërtet e kishte gruan më një sëmundje të rrallë ashtu qysh ma ka spjeguar, a jeni që ta ndihmojmë më 950 euro? Unanimisht të gjithë ishin për.

Kërkesa nr.02/32 datë:27.01.2020, e parashtruar nga përfaqësuesi i lagjes Bedri Kryeziu nga fshati Bubavec.

Rrahim Morina: Këta në këtë kërkesë kanë kërkuar me ju ndihmuar në hapjen e një bunari për ujë pra kanë kërkuar disa shtëpi, nëse ju mendoni ne këtë kërkesë ja dërgojmë Kryetarit të Komunës.

Muharrem Morina: Këtë kërkesë për me mujt me lehtë me realizuar kryetari mundet me një marrëveshje me bashkëfinancim me ata banorë që kanë kërkuar me hap atë pus, pra me procedurë të

prokurimit. Në këtë formë individuale nuk mundet me ndihmu, pastaj duhet të jenë nënshkrimet e të gjithë atyre që kërkojnë hapjen e pusit.

Rrahim Morina: Pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur, përmes kësaj përgjigje Komiteti për Politikë dhe Financa njofton parashtruesin e kërkesës se KPF nuk ka ndonjë të drejtë të vendos lidhur me këtë projekt, andaj ju sugjerohet që kërkesa duhet të jetë nënshkruar nga këto familje, pastaj duhet të sigurohet certifikata dhe kopja e planit lidhur me pronën që kërkohet hapja e pusit për ujin e pijes dhe pasi të kompletohet kërkesa të kërkohet nga kryetari i Komunës për trajtim të mëtutjeshëm lidhur me kërkesën në fjalë.

Unanimisht të gjithë ishin për.

15. Të ndryshme.

Raimonda Krasniqi: Kërkoj që për Gjendja aktuale në Gjimnazin "Hamdi Berisha" të diskutohet në mbledhjen e Kuvendit.

Rrahim Morina: Nëse mendoni e fusim si pikë për Kuvend, po ashtu të futet në kuvend pikë në rend dite, se sa mjete kanë kaluar në suficit dhe cilat projekte nuk janë realizuar në vitin 2019. Kush jeni për? Unanimisht ishin për që këto dy propozime të futen në rend të ditës.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14.35 minuta.

Procesmbajtësi

Najm Avdijaj jur. i dip

